REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPKI
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages 04
Nr. Prot Br.Prot Prot No. 06-02/1013/21
Data Datum Date 30.03.2021
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 29.03.2021, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **Mbyllet rasti AKK–DPKI-06-2448/20, për procesin e rekrutimit të gjyqtarëve në nivel të gjykatave themelore, sipas konkursit publik të shpallur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 16.12.2018, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

II. **Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për procesin e rekrutimit të gjyqtarëve në nivel të gjykatave themelore sipas konkursit publik të shpallur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në vijim: KGJK) më datë 16.12.2018, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga një palë e tretë (raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që gjyqtarë të Gjykatave Themelore (GJTH) dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës (GJA), kanë qenë pjesë përbërëse e Komisionit të rekrutimit për gjyqtarë, të cilët kanë vlerësuar bashkëpunëtorët profesional apo punonjësit e gjykatës me të cilët kanë punuar (AKK-DPKI-06-2488/20). Tutje raportuesi i rastit ka kërkuar nga Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia) të vlerësoj nëse ekziston konflikti i interesit në mes gjyqtarit si anëtar i komisionit të rekrutimit dhe bashkëpunëtorit profesional apo punonjësit të gjykatës si kandidat për gjyqtar.

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti, Agjencia ka kërkuar nga KGJK-ja dokumentacion dhe informata shtesë lidhur me procesin rekrutimit të gjyqtarëve, sipas konkursit publik të shpallur më datë 16.12.2018 (shkresa zyrtare: DPKI-06-02/2613/20). Agjencia ka pranuar nga KGJK-ja përgjigjen së bashku me dokumentacionin dhe informatat e kërkuara (shkresa zyrtare: DPKI-2754/20).

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit, informatat, sqarimet dhe dokumentacionin e pranuar nga KGJK-ja lidhur me këtë rast, përfshirë legjislacionin relevant në fuqi, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me Vendimin KGJK. Nr. 196/2018, të datës 30.11.2018, KGJK-ja ka shpallë konkurs publik për njëzet e shtatë (27) pozita të lira për gjyqtarë në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës. Konkursin publik i shpallur nga KGJK-ja ka qenë i hapur për aplikim nga data 16.12.2018 deri më datë 31.12.2018.

Me Vendimin KGJK. Nr. 121/2018, të datës 17.04.2018, KGJK-ja ka emëruar Komisionin e zgjeruar për rekrutim të gjyqtarëve të GJTH-ve, në përbërje prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve. Rrjedhimisht, Komisioni i zgjeruar për rekrutim të gjyqtarëve ka qenë i formuar para se KGJK-ja të shpallë konkursin.

Pas shpalljes së konkursit, KGJK-ja me Vendimin KGJK. Nr. 142/2019, të datës 21.06.2019, ka emëruar Komisionin për hartimin e testit kualifikues në përbërje prej nëntë (9) anëtarësh. Përbërja e këtij komisioni është si në vijim: një gjyqtar i Gjykatën Supreme të Kosovës (GJS), një gjyqtar i Dhomës së Posaçme të GJS-së, dy gjyqtarë të GJA-së dhe nga një gjyqtar të GJTH të Prishtinës, Mitrovicës, Gjakovës, Prizrenit dhe Ferizajit. Ndërsa me Vendimin KGJK. Nr. 166/2019, të datës 28.06.2019, është caktuar Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Komisionit për hartimin e testit kualifikues.

Pasi që njëri nga anëtarët e Komisionit për hartimin e testit kualifikues, gjyqtari i GJS-së, më datë 05.09.2019, ka njoftuar Kryesuesin e KGJK-së për dorëheqje nga ky komision, i njëjti me Vendimin KGJK. Nr. 196/2019, të datës 07.10.2019, është zëvendësuar nga një gjyqtar i GJTH në Gjakovë.

Ashtu siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 3 të Rregullores së KGJK-së Nr. 12/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 05/2016) për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, KGJK-ja me Vendimin KGJK. Nr. 186/2019, të datës 05.09.2019, nga radhët e Komisionit të zgjeruar për rekrutim, ka emëruar Komisionin për rekrutim të gjyqtarëve në përbërje prej pesë (5) anëtarë të rregullt dhe një (1) anëtar rezervë.

Tre (3) anëtarë të Komisionit për rekrutim të gjyqtarëve janë caktuar nga radhët e anëtarëve të KGJK-së, një (1) anëtar është gjyqtar i GJA-së dhe një anëtar është U. D. Kryetar i GJTH në Gjakovë. Ndërsa në cilësi të anëtarit rezervë të këtij komisioni është caktuar Kryetari i GJTH në Prishtinë.

Me Vendimin KGJK. Nr. 216/2019 të datës 25.10.2019, KGJK-ja ka emëruar Komisionin për rishqyrtim në përbërje prej tre (3) anëtarë të rregullt dhe dy (2) anëtarë rezervë. Në mesin anëtarëve të rregullt janë emëruar një (1) anëtar i KGJK-së, një (1) gjyqtar i GJS-së dhe një (1) gjyqtar i GJA-së. Ndërsa në cilësi të anëtarëve rezervë të këtij komisioni janë emëruar një (1) gjyqtar i GJS-së dhe një (1) anëtar i KGJK-së. Ndërkohë, KGJK-ja me Vendimin KGJK. Nr. 167/2020, të datës 03.07.2020, ka zëvendësuar njërin nga anëtarët e rregullt të Komisionit për rishqyrtim, gjyqtarin e GJS-së, me një gjyqtar tjetër të GJS-së, pasi që i njëjti është pensionuar.

Për më tepër, pas analizimit të shkresave në dispozicion, nuk është gjetur se ndonjëri nga anëtarët e komisioneve (Komisionit për rekrutim apo Komisionit për rishqyrtim) të ketë deklaruar

konfliktin e interesit apo është tërhequr nga procesi i vlerësimit ose rishqyrtimit, për shkak të konfliktit të interesit apo për ndonjë shkak tjetër. Rrjedhimisht, anëtarët rezervë të këtyre komisioneve nuk kanë marrë pjesë në vlerësimin e kandidatëve apo rishqyrtimin e ankesave të tyre.

Më datë 13.07.2020, Komisioni për rekrutim të gjyqtarëve i KGJK-së ka publikuar listën me njëzet e shtatë (27) kandidatë për gjyqtarë, të cilët, sipas pikëve të fituara në provimin me shkrim dhe intervistën me gojë, kanë kaluar me sukses procesin e rekrutimit.

Prej njëzet e shtatë (27) kandidatëve të përzgjedhur për gjyqtarë, trembëdhjetë (13) janë nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional apo punonjësve të gjykatave (GJS-së, GJA-së, GJTH-ve në Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Prizren). Vlenë të theksohet se tre (3) nga kandidatët punonjës të gjykatave, kanë qenë të angazhuar në gjykata si bashkëpunëtor të jashtëm apo zyrtar ligjor me projekte nga jashtë.

Sipas përgjigjes së KGJK-së në kërkesën e Agjencisë, lidhur me statusin e bashkëpunëtorëve profesional të gjykatave, theksohet se bashkëpunëtorët profesional janë shërbyes civil të cilët i raportojnë kryetarit të gjykatës. Nuk ka rregullore të veçantë për bashkëpunëtorët profesional, por sipas përgjigjes në fjalë, është duke u punuar në nxjerrjen e rregullores sikurse përcaktohet me Ligjin për gjykatat. Ndërsa sa i përket statusit të zyrtarëve ligjor të gjykatave, të njëjtit sipas legjislacionit në fuqi, janë shërbyes civil që për punën e tyre i përgjigjen dhe raportojnë Administratorit të Gjykatës apo Ndihmës Administratorit të Degës.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia ka analizuar pozitën në sistemin gjyqësor të secilit anëtar të komisioneve të KGJK-së në procesin e rekrutimit për gjyqtarë, si dhe pozitat e punës të secilit nga kandidatët e përzgjedhur për gjyqtar, raportin ndërmjet tyre, dhe më pas ka konstatuar se, nuk përbënë konflikt të interesit fakti që gjyqtarë të gjykatave kanë qenë pjesë përbërëse e komisioneve të KGJK-së në procesin e rekrutimit për gjyqtarë, me ç'rast kanë vlerësuar bashkëpunëtorët profesional apo zyrtarët ligjor (punonjësit) të gjykatës me të cilët kanë punuar. Kjo për faktin se një situatë e tillë nuk bie ndesh me nenin 6 dhe nenin 17 paragrafi 1, lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.6 të LPKI-së. Rrjedhimisht, nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Së këndejmi, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".*

Tutje me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."*

Me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së është përkufizuar se: "*interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë*

dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste." Ndërsa me nënparagrafin 1.6 të këtij neni është përkufizuar se: *"person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës".*

Në rastin konkret, në kuptim të dispozitave të sipërshënuara, nuk është gjetur se ndonjëri nga anëtarët e komisioneve të KGJK-së, në procesin e rekrutimit të gjyqtarëve, të ketë pasur interes privat për çështjen në të cilën kanë marrë pjesë si anëtar i komisionit përkatës. Ndërsa, personat që janë përzgjedhur për gjyqtarë nuk konsiderohen persona të afërm të tyre.

Asnjëri nga kandidatët e përzgjedhur, të cilët kanë qenë bashkëpunëtorë profesional të gjykatave, nuk janë vlerësuar nga eprori i drejtëpërdrejtë i tyre, përkatësisht nga kryetari i gjykatës përkatëse. Edhe pse U. D. i Kryetarit të GJTH në Gjakovë ka qenë anëtar i Komisionit për rekrutim, asnjëri nga njëzet e shtatë (27) kandidatët e përzgjedhur sipas listës, nuk ka qenë bashkëpunëtor profesional në këtë gjykatë. Ndërsa, sa i përket Kryetarit të GJTH në Prishtinë që ka qenë anëtar rezervë i Komisionit për rekrutim, siç është theksuar edhe më lartë, nuk është gjetur se ka marrë pjesë në proces të vlerësimit, pasi që nuk ka prova se ndonjëri nga anëtarët e rregullt të këtij komisioni është tërhequr nga komisioni.

Rrjedhimisht, fakti se gjyqtarët në cilësi të anëtarëve të komisioneve përkatëse të KGJK-së për rekrutim të gjyqtarëve, kanë marrë pjesë në hartimin e testit kualifikues, vlerësimin e kandidatëve dhe shqyrtimin e ankesave të kandidatëve, disa prej të cilëve kanë qenë bashkëpunëtorë profesional apo zyrtar ligjor (punonjës) të gjykatës në të cilën kanë punuar, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit. Kjo ngase gjyqtari apo kryetari i gjykatës dhe bashkëpunëtori profesional apo zyrtari ligjor i gjykatës, nuk konsiderohen persona të afërm në kuptim të dispozitës së nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të LPKI-së. Sepse raporti gjyqtar apo kryetar i gjykatës – bashkëpunëtor profesional apo zyrtar i ligjor i gjykatës, është raport profesional i punës, jo raport që cilësohet si "person i afërm me zyrtarin" sipas dispozitës së sipërshënuar.

Agjencia ka shqyrtuar këtë rast, në kuadër të pretendimeve të raportuesit të rastit, vetëm në aspekt të vlerësimit nëse paraqet konflikt të interesit fakti që gjyqtarë të gjykatave kanë qenë pjesë përbërëse e komisioneve të KGJK-së për procesin e rekrutimit për gjyqtarë, me ç'rast kanë vlerësuar bashkëpunëtorët profesional apo punonjësit e gjykatës me të cilët kanë punuar.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit